



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 74

Prishtinë, më 15.6.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naim Maloku, Zulfi Merxha, Elheme Hetemi, Ali Lajçi, Zef Morina, Berat Luzha, Myrvete Pantina, Heset Cakolli.

Mungoi : Naser Rugova, Branislav Grbić, Selvie Halimi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi **Naim Maloku**, nënkryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 11.6.2010,
3. Këshilli për Planifikim Hapësinor,
4. Rekomandimi për p/l për mbrojtjen e natyrës dhe GP për VNM,
5. Vizita në Bruksel, bisedë me znj. Iva Stamenova.

1. Nënkyetari përshëndeti mysafirët e nderuar, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës**, për të cilat nuk kishte vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 11.6.2010

Nënkyetari konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Anëtarët e propozuar për Këshillin për Planifikim Hapësinor

Naim Maloku pasi që mori sqarimet nga stafi konstatoi se gabimisht është renditur kjo pikë e rendit të ditës ngase zgjedhja e këshillit për planifikim hapësinor është kompetencë e Qeverisë, çka është konstatuar edhe nga koordinatori i lidhjes midis Kuvendit dhe Qeverisë z. Nagip Tahiri.

4. Rekomandimi për projektligjin për mbrojtjen e natyrës dhe caktimi i GP për VNM

Naim Maloku lidhur me projektligjin për mbrojtjen e natyrës tha se duhet të përjetoi fatin e ngjashëm sikurse ajo për OMGJ ngase e njëjta duhet të tërhiqet në ripunim si solucion më i

kapshëm që ka dalur nga biseda me zyrtarët dhe eprorët e departamentit ligjor. Ai hapi debatin, ndërsa **Zef Morina** arsyetoi plotësisht këtë sugjerim ngase edhe më herët është vërejtur se do të kemi probleme për ta përmirësuar një projekt me dy versione, ndaj është mirë që Qeveria ta bëjë ligjin ashtu si duhet. **Zylfi Merxha** gjithashtu përkrahu mendimet e shfaqura në departamentin ligjor bashkë me sugjerimin e nënkryetarit. **Myrvete Pantina** u pajtua me sugjerimin e dhënë nga nënkryetari ngase si duket nuk kemi zgjidhje tjetër, tha ajo, mirëpo shfaqti habin “si erdhi deri te kjo dhe si dalim ne para deputetëve”.

Naim Maloku tha se në Kuvend kanë ardhur dy projekte, njëra zyrtare me 208 nene dhe tjetra me 177 nene pak ditë më vonë, ndaj sqaroi se këtë çështje ka menduar më shpejt ta kryej pasi që atij i ka takuar të procedoi në mungesë të kryetarit, me amendamente, mirëpo kur është vërejt interferimi i neneve me projektin e dërguar më vonë, është ardhë në përfundim të përbashkët me zyrtarët se nuk ka mundësi të rregullohet ndryshe pos të kthehet dhe të vjen prapë të vazhdoi puna në Kuvend, prandaj e siguroi deputeten Pantina që mos të brengoset ngase puna e Kuvendit monitorohet dhe shumë lehtë sqarohen gjërat apo fajësia nëse kërkohet. Ai sugjeroi që rekomandimi për mbledhjen plenare të bëhet pa debat por direkt në votim, ashtu si do të sugjeroi ai në grupin parlamentar. **Heset Cakolli** tha se gjatë diskutimit të nënkryetarit ka dëgjuar fjalën “kinse” ndaj ai tha se këtu nuk kemi të bëjmë me kurfar “kinse” por të shkohet sipas procedurës që parashihet me rregullore, çka në këtë rast nuk kundërshtohet asgjë me sugjerimin e dhënë nga nënkryetari.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. I Rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës që në mbledhjen plenare mos të miratoi projektligjin për Mbrojtjen e Natyrës në leximin e dytë, përkatësisht të kthehet Qeverisë në ripunim.

2. Grupi i punës i caktuar në komision për këtë projektligj mbetet në fuqi për të vazhduar punën rreth shqyrtimit pasi të dërgohet projektligji sërish nga Qeveria.

Naim Maloku në vazhdim propozoi të veprohet sipas leximit të parë të **VNM** që ishte më 4 qershor, ndaj komisioni u pajtua që Grupi punues për këtë projektligj të caktohet si vijon : **Naser Rugova-kryesues** dhe **anëtarë Branislav Grbiç**. Nëse ka nevojë kryesuesi cakton edhe ndonjë deputet tjetër përveç këshilltarit Qazim Kukalaj, koordinitorit të komisionit dhe zyrtarëve të MMPH.

5. Vizita në Bruksel (e ftuar Iva Stamenova)

Naim Maloku ftoi mysafiren nga KE dhe sugjeroi që poçes ka probleme teknike (ose komplikime tjera) të shtyhet vizita më vonë për tetor.

Iva Stamenova tha se nuk ka komplikime kurfare por vetëm ka ardhur të konfirmoi në komision vizitën për 21-23 qershor në Bruksel ngase nikoqirët janë njoftuar dhe çdo gjë është e gatshme, nga ministria e bujqësisë sot do të blihen biletat, gjithashtu është një rast i mirë për takime të përbashkëta ngase atje do të qëndrojnë në këtë interval edhe një pjesë e Kryesisë së Kuvendit në krye me kryetarin Jakup Krasniqin.

Naim Maloku në emrin e delegacionit falënderoj për të gjitha rreth vizitës dhe sugjeroj udhëheqësin e delegacionit, kryetarin **Naser Rugova**, të enjten në pauzën e seancës të bisedoj me anëtarët e delegacionit rreth organizimit sa më të mirë të kësaj vizite.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 13,50.

Nënkryetari i Komisionit,
Naim Maloku

